








TË KUPTOJMË BUXHETIN E SHËTETIT









TË KUPTOJMË BUXHETIN E SHTETIT...

Çdo individ apo familje, i planifikon shpenzimet në bazë të shumës së parave që ka në dispozicion. Me fjalë të tjera, një familje, e llogarit koston e jetesës së saj sipas një buxheti – të ardhurave që ka dhe të cilat mund t'i shpenzojë për t'u ushqyer, për t'u veshur, për të paguar qiranë, për të defryer etj.. Ky plan bëhet për periudha të caktuara për shembull, shpenzimet e familjes llogariten për një periudhë 15-ditëshe apo për një muaj.

BUXHETI
=
PLAN FINANCIAR;
LISTË E TË ARDHURAVE DHE
SHPENZIMEVE PËR NJË PERIUDHË TË
CAKTUAR KOHE.

Në të njëjtën mënyrë, edhe qeveria i planifikon shpenzimet e saj në varësi të buxhetit që harton. Ajo programon sesa nga të ardhurat e saj do të shpenzohen për nevojat të ndryshme të shtetit si për shembull, për pagat e punonjësve të administratës, për pensionet, për spitalet, për arsimin, për mbrojtjen e vendit etj.. Ndryshe nga buxheti i familjes, buxheti i qeverisë planifikohet për një periudhë të caktuar që quhet "vit buxhetor". Ky vit përbëhet nga 12 muaj dhe sipas standardeve të vendosura në vendin tonë është i njëjtë me vitin kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor (*në disa vende ky vit shtrihet në periudhën shtator - tetor i vitit të ardhshëm ose mars - prill i vitit tjetër*).


Ndonëse në koncept është e njëjta gjë, procesi i hartimit, paraqitja dhe miratimi i buxhetit të shtetit për një vit është më i komplikuar sesa përgatitja e buxhetit të familjes apo e atij personal. Ai mbështetet në analizat për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit dhe përputhet me politika afatgjata të qeverisë.


PROCESI I HARTIMIT, I ZBATIMIT DHE I RAPORTIMIT TË BUXHETIT TË SHETIT.

Procesi i hartimit të projektbuxhetit kalon nëpër këta hapa:

1. Ministri i Financave, brenda datës 10 korrik të çdo viti buxhetor nxjerr udhëzimin për përgatitjen e projektbuxhetit nga të gjitha institucionet buxhetore. Në këtë udhëzim përcaktohen politikat që do të ndiqen, kriteret që do të përdoren për përgatitjen e buxhetit, procedurat dhe afatet për t'u respektuar në paraqitjen e kërkesave për shpenzime nga të gjitha institucionet.

2. Institucionet buxhetore, brenda datës 1 shtator, duhet të dërgojnë pranë Ministrisë së Financave kërkesat e tyre sipas udhëzimit. Në





bazë të këtyre miniprojektbuxheteve, Ministria e Financave bën analizën në total të nivelit të të ardhurave, të kërkesave për shpenzime, të numrit të të punësuarve në institucionet buxhetore, propozon rregullimet e nevojshme në varësi të burimeve buxhetore etj..

3. Pasi është bërë harmonizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjitha institucionet buxhetore, Ministri i Financave harton projektbuxhetin e shtetit dhe e dërgon për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, brenda muajit tetor. Projektbuxheti shoqërohet nga një analizë nëntëmujore e treguesve të buxhetit për vitin në vazhdim dhe nga argumentet për planifikimin e tyre për vitin tjetër fiskal. Në mënyrë të përmbledhur, prezantohen tabela me të ardhurat dhe shpenzimet si për vitin e kaluar, për atë në vazhdim dhe ato për vitin e ardhshëm.

4. Pasi studiohet dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, projektbuxheti dërgohet për diskutim dhe miratim në Kuvend brenda datës 20 nëntor. Në emër të Këshillit të Ministrave, është Ministri i Financave ai që prezanton projektbuxhetin e shtetit përpara Kuvendit dhe jep shpjegimet e duhura rreth tij.

5. Pasi diskutohet në Kuvend dhe bëhen ndryshimet e nevojshme, projektbuxheti miratohet dhe merr formë të prerë. Kjo do të thotë se shuma e parashikuar për shpenzime është kufi maksimal dhe se tejkalimi i këtij kufiri do të bëhet me miratimin e Kuvendit.


6. Procesi i përgatitjes së buxhetit përfundon me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

PROCESI I ZBATIMIT DHE I RAPORTIMIT TË BUXHETIT.

Me miratimin e buxhetit, bëhet shpërndarja e fondeve në institucionet buxhetore (organet ekzekutive të pushtetit qendror, të pushtetit lokal dhe të pushtetit gjyqësor). Secili prej këtyre institucioneve është përgjegjës për administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të caktuara për të. Institucionet buxhetore i raportojnë Ministrisë së Financave periodikisht, në mënyrë të hollësishme, mbi të ardhurat e mbledhura dhe mbi shpenzimet e kryera prej tyre.

Para mbarimit të vitit buxhetor (31 dhjetor), Ministri i Financave nxjerr udhëzimin për procesin e mbylljes përfundimtare të llogarive të të ardhurave dhe të shpenzimeve të të gjitha institucioneve buxhetore. Në bazë të analizës së kryer mbi bilancet përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të tyre, Ministria e Financave brenda datës 15 maj, harton gjendjen përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit për vitin paraardhës. Ky bilanc i paraqitet Këshillit të Ministrave dhe më pas i dërgohet Kuvendit Popullor brenda muajit qershor.

Këtu përfundon dhe
odiseja e *hartimit*, e
zbatimit dhe e
raportimit të buxhetit të
shtetit për një vit
buxhetor.



SHPENZIMET DHE TË ARDHURAT E QEVERISË.


Treguesit fiskalë sipas projektbuxhetit 2004

në milion lekë

TOTALI I TË ARDHURAVE (I+II+III+IV)	198,052	TOTALI I SHPENZIMEVE (I+II+III)	240,360
I. Grantet	6,622	I. Shpenzime korente	185,744
II. Të ardhura tatimore gjithsej (1+2)	136,936	1 Personeli	51,052
II.1 Nga tatimet dhe doganat	125,592	2 Interesat	31,082
1 Tatimi mbi vlerën e shtuar	57,148	3 Shpenzime operative mirëmbajtje	22,286
2 Tatimi mbi fitimin	15,200	4 Subvencionet	4,165
3 Akcizat	16,232	5 Shpenzime për sigurime shoqërore	44,353
4 Tatimi mbi të ardhurat personale	8,162	6 Shpenzime për sigurime shëndetsore	5,150
5 Taksa nacionale dhe të tjera	12,550	7 Shpenzime të buxhetit lokal	17,621
6 Taksa doganore	14,700	8 Ndihma ekonomike	8,435
7 Taksa e qarkullimit të automjeteve	1,600	9 Të tjera	1,600
II.2 Të ardhura nga pushteti lokal	11,344	II. Fondi rezervë dhe kontigjencë	6,100
III. Të ardhura buxhetore të pavarura (kontribute)	33,688	III. Shpenzime kapitale	48,516
1 Sigurimi shoqëror	30,888		
2 Sigurimi shëndetsor	2,800	DEFICITI	-42,308
IV. Të ardhura jostatimore	20,806		
1 Fitimi nga Banka e Shqipërisë	7,500	FINANCIMI DEFICITIT	42,308
2 Të ardhura nga institutet buxhetore	9,006	I brendshëm	28,300
3 Dividentë dhe të tjera	4,300	I huaj	14,008


Disa nga shpenzimet që ka një familje për një periudhë të caktuar janë të një natyre të përhershme si për shembull, qiraja e shtëpisë apo faturat e energjisë elektrike dhe të ujit, ndërsa disa shpenzime të tjera mund të kryhen në varësi të preferencave individuale për shembull, sa do të harxhohet për të blerë rroba të reja, për të shkuar në kinema, për të drekuar në restorante etj..


E njëjta gjë ndodh edhe kur vjen fjala për shpenzimet që kryen qeveria. Disa prej tyre janë të përhershme si për shembull, pagesa e pensioneve, ndihma ekonomike për të papunët, për shërbimet shëndetsore etj.. Ndërsa disa të tjera varen nga planet dhe strategjia e qeverisë, si për shembull



shpenzimet për ndërtime, për investime në infrastrukturë, në bujqësi, për modernizimin e mbrojtjes së vendit etj.. Këto shpenzime ndryshojnë në sasi dhe në lloj, në varësi të përparësive që ka qeveria në kohëra të ndryshme. Kështu, gjatë luftës së ftohtë për shembull, shpenzimet për mbrojtjen e Rusisë në fund të vitit 1989 zinin 15 deri në 17 për qind të prodhimit të vendit, ndërsa në vitin 1998 ato zinin 2.7 për qind. Në Shqipëri, në vitin 1994 shpenzimet për transport dhe komunikacion zinin 2 për qind, ndërsa në vitin 2001 ato zinin 10 për qind të shpenzimeve në total.

Grafik 1. Shpenzimet buxhetore sipas funksionit (Shtator 2003).





Pjesën më të madhe të shpenzimeve në buxhetin e Shtetit Shqiptar e zënë shpenzimet operative – për pagat e punonjësve, për sigurimet shoqërore e shëndetsore, ndihmat ekonomike etj., ndërsa një pjesë tjetër e zënë shpenzimet për investime publike – për rregullimin e rrugëve, të urave, të territoreve, investimet në objekte publike etj..

Po ku i gjen qeveria të ardhurat për të mbuluar këto shpenzime? Ashtu si shpenzimet e një familjeje mbulohen kryesisht nga pagat e familjarëve apo nga të ardhura të tjera nga biznese të ndryshme me të cilat merret ajo, edhe qeveria ka burimin e vet të “parave”. Të ardhurat e qeverisë sigurohen kryesisht nga taksat dhe tatimet mbi aktivitetet e individëve apo të bizneseve private.

Qeveria mbledh të ardhura nga individët dhe nga bizneset në formën e tatimeve dhe taksave. Tatimet janë të detyrueshme dhe periodike, dhe llogariten mbi shitjen e prodhimeve apo shërbimeve, mbi të ardhurat personale, mbi fitimin e bizneseve, mbi sasinë dhe llojin e mallrave që kalohen brenda apo jashtë kufirit të vendit, në formën e sigurimeve shoqërore e shëndetsore etj..

Taksat nga ana tjetër, paguhet për shërbimet publike që sigurohen nga qeveria. Këto ndahen në taksa kombëtare dhe taksa vendore. Ndër taksat kombëtare përmendim:

1. Taksa portuale.
2. Taksa për shërbimet konsullore.
3. Taksa e importimit të automjeteve të përdorura.
4. Taksa e pajisjes me lejedrejtimi për drejtim automjeti.
5. Taksa për shërbimet e radiokomunikacioneve.

6. Taksa e përdorimit të numrit telefonik.
7. Taksa për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme etj..
8. Taksa e regjistrimit në arsimin e lartë.
9. Taksa për ulje-ngritjen e avionëve dhe për qëndrimin e tyre në aeroport.
10. Taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin.
11. E të tjera...

Taksat vendore përfshijnë:

1. Taksa mbi pasuritë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
3. Taksa për zënien e hapësirave publike.
4. Taksa e tabelës.
5. E të tjera...


Pra, qeveria mbledh nga individët të ardhura në formën e tatimeve dhe taksave dhe paguan po prapë individët në formën e pensioneve, të ndihmës ekonomike, të sigurimeve shoqërore e shëndetsore etj.. Fakti që individët paguajnë një kontribut të caktuar gjatë viteve të punës, pikërisht për të siguruar të ardhura gjatë jetës në pension apo gjatë periudhave të papunësisë (për arsye të ndryshme), të krijon përshtypjen se pikërisht ky kontribut të rikthehet pas një periudhe relativisht të gjatë kohe.

Në fakt është ndryshe. Të ardhurat që qeveria i përdor për pagesën e pensioneve apo të ndihmës ekonomike etj., e kanë bazën në taksat e mbledhura pikërisht në vitin kur zbatohet buxheti, domethënë, ato vijnë nga mbledhja e taksave të

momentit. Pra, në çdo periudhë, janë kontributet e punonjësve aktualë dhe të brezave të rinj, të cilat përdoren për të paguar shpërblimet për brezat më të vjetër.

Burime të tjera të të ardhurave për qeverinë janë edhe fitimet nga shoqëritë shtetërore, nga pagesat e detyrimeve të investitorëve të huaj, nga fondet e siguruara nga ndihma apo kredi nga jashtë etj..

Grafik 2. Të ardhurat buxhetore sipas burimit (Shtator 2003).



Kështu, sa më të mëdha të jenë të ardhurat, aq më të mëdha janë edhe mundësitë për investime nga ana e shtetit. Dhe kur kjo rritje e aktivitetit ekonomik bëhet realitet, thuhet se ekonomia po lulëzon. Prej saj përfitojnë jo vetëm individët – të cilët mund të gjejnë punë më lehtë, mund të paguhen më mirë etj., por edhe bizneset, fitimet e të cilëve janë më të

mëdha. Nga ana tjetër, rriten dhe shumat që paguajnë njerëzit për të ardhurat apo për fitimet që marrin, duke sjellë shtimin e të ardhurave të qeverisë. Dhe cikli vazhdon drejt arritjes së një ekuilibri të dëshiruar.


DEFICITI BUXHETOR

Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve përbën atë që quhet suficit – kur të ardhurat janë më të larta se shpenzimet ose deficit – kur shpenzimet janë më të larta se të ardhurat buxhetore.

Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të Qeverisë në Shqipëri gjatë këtyre 10 vjetëve të fundit është barazuar me deficite. Kjo është një gjë normale për vendet në tranzicion. Të ardhurat nuk realizohen për shkak se jo të gjithë tatimpaguesit janë korrektë me ligjin dhe i shmangen detyrimeve për të paguar; për shkak të vështirësive në mbledhjen e taksave; për shkak të politikave sociale që ndjek vendi etj., ndërsa shpenzimet janë të larta për shkak të peshës së madhe të investimeve publike etj.. Por, deficitet nuk janë të pazakontë as për vendet e zhvilluara. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një nga vendet më të zhvilluara në botë, kanë rezultuar me deficit buxhetor për 30 vjet me rradhë, deri në vitin 1998. Prandaj, nuk është aspak alarmante të mendosh se edhe për vite të tjera, në Shqipëri, shpenzimet mund të tejkalojnë të ardhurat e qeverisë.

Zakonisht, për të vlerësuar sesa i thellë është deficitet buxhetor i një vendi, llogaritet raporti i tij me prodhimin e një vendi (Prodhimi Brendshëm Bruto). Kjo shifër tregon se ç'pjesë të vlerës së prodhimit të përgjithshëm të ekonomisë zë deficitet buxhetor i shtetit.

Grafik 3. Deficiti buxhetor në përqindje ndaj PBB-së, për Shqipërinë.



FINANCIMI I QEVERISË

Për të mbuluar deficitin buxhetor, qeveria merr hua të brendshme dhe të jashtme ose ndryshe thuhet se financohet nga burime të brendshme dhe të jashtme.

Huamarrja e brendshme sigurohet nga subjekte të përcaktuara paraprakisht që përfshijnë banka, institucione financiare dhe jofinanciare dhe individë. Kredia që merr qeveria është në formën e letrave me vlerë të qeverisë ose siç quhen ndryshe, *bono thesari*. Pra, qeveria emeton bono thesari me vlera të caktuara, të cilat blihen nga individë, nga banka apo nga institucione të tjera financiare për një kohë të përcaktuar më parë. Pas mbarimit të kësaj kohe (ose kur matorohen bonot e thesarit) qeveria i riblen letrat me vlerë dhe së bashku me çmimin fillestar me të cilin i ka shitur, ajo i paguan edhe një interes mbajtësit të tyre. Ky interes është shpenzim për qeverinë dhe fitim për atë që i kishte blerë bonot e thesarit. Për qeverinë, kjo lloj marrëveshjeje është një

formë për të marrë hua për një periudhë të caktuar (koha e maturitetit të bonove), ndërsa për palën tjetër kjo është një formë investimi, pasi për shumën e parave me të cilat blihen bonot, blerësi merr një interes¹.


BANKA QENDRORE SI KREDITORE E QEVERISË.

Në praktikën botërore, si subjekte huadhënëse për qeverinë bëjnë pjesë edhe bankat qendrore ndonëse ato përpiqen të kufizojë pjesëmarrjen e tyre në këtë aktivitet. Për shembull, në statutin e Bankës Qendrore Evropiane, përmendet qartë se bankat qendrore, anëtare të Bashkimit Evropian, nuk mund të ofrojnë kredi për qeveritë e tyre.

Kjo sjellje e bankave qendrore buron nga fakti se ndërsa subjektet e tjera përdorin kursimet e tyre për të financuar qeverinë, bankës qendrore i duhet të presë para të re për ta bërë këtë. Dalja e parave në qarkullim, me qëllim financimin e deficitit buxhetor përbën një ndër problemet kryesore, që kërcënon stabilitetin monetar për çdo ekonomi. Kjo dukuri bëhet më shqetësuese në vendet në zhvillim, pasi shtimi i parave në qarkullim do të ndikonte menjëherë në rritjen e normës së inflacionit – rritjen e çmimeve.

Megjithatë, në kushtet e ekonomisë së tranzicionit, kur qeveria ka gjithmonë nevojë për financim, huamarrja vetëm nga bankat tregtare nuk është gjithmonë e mjaftueshme. Një pjesë të fondeve të grumbulluara në formën e depozitave, bankat tregtare i vënë në përdorim për kreditimin e biznesit

¹Për më shumë informacion mbi bonot e thesarit dhe procesin e blerje-shitjeve të tyre, konsultohuni me broshurën "Bonot e thesarit", Banka e Shqipërisë, shkurt 2003.



privat, pra krijojnë një portofol të investimeve të tyre dhe zhvendosja e fondeve në favor të qeverisë, do të thotë më pak kredi për ekonominë private. Për të mbushur këtë boshllëk mund të ndihmojë banka qendrore.

Banka e Shqipërisë, si një institucion që aktivitetin e vet e zhvillon në kushtet e një ekonomie në tranzicion, financoi qeverinë nëpërmjet kredisë direkte. Përqindjet e lejuara për financim janë përcaktuar duke marrë për bazë teoritë ekonomike të ndërtuara për këtë qëllim, përvojën e vendeve të tjera, konsultimet me ekspertët e organizmave ndërkombëtarë. Masa e lejuar për financimin e qeverisë nga banka qendrore shprehet në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

Sipas nenit 30 pika 4 të këtij ligji:

"... Për çdo kredi ose hua duhet të përfundohet marrëveshja me shkrim e kredisë ose e huasë midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Bankës së Shqipërisë. Marrëveshja duhet të përcaktojë qartë shumën kryesore të kredisë ose të huasë, maturimin e saj, normat e aplikuara të interesit dhe kushte e shpenzime të tjera të mundshme. Në asnjë rast shuma kryesore e kredisë ose huasë së disbursuar dhe pjesa e padisbursuar e kredisë ose huasë së Bankës së Shqipërisë dhënë Qeverisë të Republikës së Shqipërisë, nuk duhet të kalojë vlerën pesë për qind të mesatares vjetore të të ardhurave të buxhetit të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për tre vitet e fundit financiare ..." ²

² Ligji "Për Bankën e Shqipërisë" dhe amendamentet e bëra atij.


Ky nivel kreditimi nuk bie ndesh me objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë “*arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve*”. Madje në përputhje me nivelin e përshtatshëm të parasë në qarkullim, për raste të jashtëzakonshme, është pranuar që të lejohet një rritje e këtij niveli deri në 8 për qind.

Ajo çfarë shprehet në ligj dhe zbatohet në praktikë, përbën një arritje të madhe për Bankën e Shqipërisë. Po të hedhim një vështrim në periudhën përpara vitit 1997, do të vëmë re se financimi i qeverisë nga Banka e Shqipërisë ka qenë pa asnjë kufizim, gjë që cënonte pavarësinë e Bankës. Neni 30 i ligjit, me përcaktimin e tij, synon realizimin në praktikë të pavarësisë së bankës nga pushteti ekzekutiv. Marrëdhënia midis Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë Shqiptare përcaktohet si marrëdhënie kontraktuale, që përfshin kreditorin, debitorin dhe interesin e huasë. Mbi të gjitha, kjo marrëdhënie bëhet publike duke rritur shkallën e transparencës.

Ligji përcakton se Banka e Shqipërisë, përveç huasë direkte, mund të ndihmojë qeverinë me fonde edhe nëpërmjet riinvestimit të letrave me vlerë të qeverisë, që Banka tashmë ka në zotërim. Por edhe në këtë rast, financimi nga Banka është i kufizuar pasi asaj nuk i lejohet të blejë letra të tjera me vlerë dhe nuk mund të riinvestojë me afate më të gjata se gjashtë muaj.

Pra, kemi të bëjmë me kufizime në sasi dhe në kohë. Kjo bën që kur qeveria ka nevojë për financime më afatgjata, t’u drejtohet individëve dhe bankave tregtare.

Pra, me pak fjalë, ndonëse Banka e Shqipërisë shërben si bankier, si këshilltar, si ndërmjetës fiskal i qeverisë, ajo nuk mund të mbështesë pa kriter qeverinë në nevojat për financim. Në këtë mënyrë respektohen përpjekjet e Bankës për të arritur objektivin e vet kryesor.





Huamarrja e jashtme. Përveç borxhit që qeveria merr nga publiku i brendshëm, ajo mund të marrë kredi nga shtete të tjera e institucione financiare ndërkombëtare në afate të gjata. Kreditë kanë norma të caktuara interesi dhe bazohen në kontrata midis qeverisë shqiptare dhe këtyre institucioneve.

BORXHI PUBLIK.

Ndonëse mund të duket e çuditshme, qeveria detyrohet të marrë borxh edhe kur të ardhurat janë njësoj me shpenzimet. Kjo për arsye se ajo vazhdimisht është e detyruar të paguajë borxhet e mëparshme, domethënë edhe kur për momentin nuk i nevojitet të marrë borxh, ajo shpenzon për borxhin që ka marrë në periudhat më përpara dhe që e shlyen tani.



Kështu, qeveria nuk mund t'i shlyejë të gjitha huatë e saj brenda një viti, pasi momenti i shlyerjes së tyre përkon me periudha të ndryshme. Prandaj, ndryshe nga të ardhurat, shpenzimet dhe deficitet buxhetor, që maten në periudha një vit fiskal, borxhi i qeverisë përmbledh tërë huatë e papaguara ende nga qeveria në vite.

Në këto kushte, është barrë e qeverive pasardhëse shlyerja e këtyre borxheve kur ato maturohen. Në njëfarë mënyre, ky sistem nuk i lejon qeveritë të shpenzojnë pa kriter me justifikimin se mund të marrin borxh për të mbuluar shpenzimet. Duke qenë se publiku është huadhënësi kryesor dhe, siç u përmend borxhet e mbartura janë detyrim i qeverive pasardhëse, për politikën e qeverisë për huamarrjen interesohet dhe gjykon edhe vetë publiku.





Tani që e dini se ç'është buxheti, e kuptoni më mirë rëndësinë që ka planifikimi i tij. Ai është dokumenti më i rëndësishëm i qeverisë pasi reflekton politikën e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Niveli i treguesve buxhetorë duhet të jetë në harmoni me tregues të tjerë të ekonomisë. Një nivel i lartë shpenzimesh mund të çojë në rritje të parasë që qarkullon në ekonomi e në rritje të çmimeve. Në rast se kryerja e shpenzimeve të mëdha gjykohet si e nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të vendit, atëherë duhen menduar burimet sesi do të mbulohen këto shpenzime, në mënyrë që të krijohet një ekuilibër. Sigurisht që gjetja e ekuilibrit nuk është aq e thjeshtë, prandaj edhe hartimi i buxhetit dhe më pas miratimi i tij janë gjithmonë dhe kudo objekt debati.



21



Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1,
Tiranë.

Tel: (355) 4 222230; 235568; 235569.

Faks: (355) 4 223558.

e-mail: public@bankofalbania.org

[http: //www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi: 1000 kopje.

